



Planuar / Doretuar Punëna / Pradato Received / Delivered	01.11.2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Shënia Org. Unit	Nr. Prot. Pr. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	6816/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1169/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1169/2023 të datës 18.09.2023, të parashtruar nga ankuesi

[redacted] kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.10.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1169/2023 e datës 18.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.12-06-3206 i datës 22.08.2023 i Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.287/2022 të datës 27.12.2022 në pozitën e punës “Inspektor i Lartë për Hetime Tatimore” në Administratën Tatimore të Kosovës. Përmes kërkesës me numër të protokollit Nr. ZQ/12-06/2066 të datës 18.05.2023 në pajtim me dispozitat të Kodit të Mirësjelljes dhe Udhëzimin Administrativ 17/2009 –ruajtjen e integritetit të ATK-së i është drejtuar Zyrës së Standardeve Profesionale, në Administratën Tatimore të Kosovës.

Më datë 19.05.2023 Udhëheqësi në Divizionin e Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerrë Vendim me numër Nr.12-06-2077 me të cilin e ka refuzuar kërkesën me numër të protokollit Nr. ZQ/12-06/2066 të parashtruar nga ankuesi për angazhim në punë sekondare në pozitën e "Eksperti Pavarur Financiar" te subjekti "Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.12-06-2277 të datës 19.05.2023 të Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 16.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4799/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi i atakuar ka të beje me shkelje esenciale te procedurës administrative, vërtetim jo të plot edhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatim të drejtës materiale administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 31.07.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.857/2023, me të cilin e ka obliguar Divizionin e Standardeve të Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë Rishqyrtimin e lëndës për ankuesin [REDACTED]

Divizioni i Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës, pas pranimit të Vendimit me numër A.nr.857/2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.07.2023 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.12-06-3206 përmes të cilit i ka refuzuar kërkesën e ankuesit për angazhimin e tij në punë sekondare.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.12-06-3206 të datës 22.08.2023 të Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 18.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 6132/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.09.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë te Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli me po të njëjtën datë ka pranuar përgjigjen në nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër të protokollit 6132/2023 të datës 18.09.2023 te parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 12.06.3206 të datës 22.08.2023; Përgjigjenin në kërkesë për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit të datës 12.07.2023; Vendimin me numër A.nr.857/2023 të datës 31.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën me numër të protokollit 4799 /2023 të datës 16.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër Z.Q/ 12.06.2077 të datës 19.05.2023; Aktin e emërimit me numër A.E. Nr.287/2022 të datës 21.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.06.2023; Përgjigjenin në ankesë me numër të protokollit 857/2023 të datës 07.07.2023;

Vendimin me numër 2224 të datës 20.12.2022; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës; Aplikacionin e kërkesës për punë sekondare- Aktivitetet jashtë ATK-së me numër AP/12.06.2066 të datës 18.05.2023; Rregulloren e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit në administratën tatimore të Kosovës me numër ZQ-09-06-4014 të datës 03.09.2021 Shtojca Nr.1 aplikacionin për punë sekondare aktivitetet jashtë Administratës Tatimore të Kosovës; Formularin e deklaratës mbi gjendjen e konfliktit të interesit; Shtojca Nr.3 Tabela 1. Deklarata me mirëbesim për personat familjar që kanë biznes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe ka analizuar të gjitha provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht Aktit të Emërimit të ankuesit me numër AE. Nr. 287/2022 të datës 27.12.2022, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se i njëjti është i punësuar në pozitën e punës "Inspektor i Lartë për Hetime Tatimore" në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa më datën 18.05.2023 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit Nr.prot.12.06-2066 në Zyrën e Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës përmes së cilës kërkon që ti lejohet puna sekondare si "Ekspert Gjyqësore në Lëmin Financiare" pas orës 16 gjegjësisht pas orarit të rregullt të punës me afat të pa caktuar kohorë (varësisht nga kërkesa, pasi që është pune freelance).

Divizioni i Standardeve në zbatim të Vendimit me numër A.nr.857/2023 të datës 31.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka rishqyrtuar edhe njëherë lëndën e ankuesit dhe më datë 22.08.2023 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.12-06-3206 përmes së cilit e ka refuzuar përsëri kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se pozita e "Inspektor i lartë për hetime tatimore" ka natyrë specifike të punës dhe në Administratën Tatimore të Kosovës janë përcaktuar kufizime të veprimtarive jashtë ATK-së si masa për mbrojtje të integritetit, të cilat kufizime mbështeten edhe në nenin 11 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike andaj angazhimi në punë sekondare në pozitën e „Ekspert i Pavarur Financiar,, me pozitën e Inspektorit tatimor konsiderojmë që është e pa papajtueshme sepse nga kjo mund të dëmtohet reputacioni i ATK-së. Po ashtu Divizioni i Standardeve në këtë Vendim refuzues thekson edhe mungesën e inspektorëve tatimor, brenda organit të punësimit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se „2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike” si dhe neni 29 i këtij ligji që përcakton detyrimin për deklarimin dhe shmangien e konfliktit të interesit ku theksohet qartë se „1. Zyrtari publik ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në pajtim me ligjin. 2. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë pa vonesë mbikëqyrësin e tij, në rast

dysshimi për një konflikt interesi dhe të zbatojë urdhrat e institucionit për parandalimin e konfliktit të interesit. 3. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë paraprakisht mbikëqyrësin e tij dhe njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për çdo veprimtari me pagesë, që kryen jashtë detyrës së tij vetëm në pajtim me ligjin" si dhe dispozitat e Rregullores e Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. "Zyrtari i ATK mund të angazhohet në punë sekondare në lëmit si: shkencë, sport, mësimdhënie, trajnime, seminare, hulumtime borde (Ndërmarrje Publike, Ndërmarrje Shoqërore dhe Organizata Buxhetore) kulturë dhe veprimtari humanitare. Këto aktivitete mund të ushtrohen nga zyrtari i ATK, nëse nuk ka konflikt të interesit apo nëse aktiviteti nuk është i ndaluar me dispozitat tjera ligjore", dhe nenin 7 paragrafin 6 nën paragrafin 6.2 dhe 6.3 ku përcaktohet qartë se: 6.Zyra e Standardeve Profesionale refuzon kërkesën për angazhim në punë sekondare, në rastet kur: "6.2. Angazhimi në punë sekondare bie ndesh me legjislacionin për konfliktin e interesit; 6.3. Angazhimi në punë sekondare pengon aktivitetin në ATK", po ashtu ka analizuar edhe Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publik nenin 11 ku përcaktohet qartë se: 1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse: "1.1. mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private; 1.2. punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë; 1.3. angazhime të tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit; 1.4. angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në institucione vartëse të institucionit punëdhënës, me përjashtim kur një angazhim i tillë është paraparë me ligj të veçantë", andaj marrë parasysh përcaktimin ligjor si më sipër, Kolegji konstaton se marrëdhënia e punës në shërbimin civil është marrëdhënie primare dhe se nëpunësi civil mund të angazhohet në veprimtari/punë sekondare/punë jashtë shërbimit civil vetëm në rast se ky angazhim nuk sjell rrethana të konfliktit të interesit në raport me ushtrimin e punës në shërbimin civil dhe nuk pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare apo realizimin e objektivave të institucionit.

Prandaj, Kolegji i Këshillit mbi këtë bazë dhe po ashtu bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr. 12-06-3206 të datës 22.08.2023 me të cilin e ka refuzuar kërkesën për lejimin e punës sekondare të ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartë cekura sepse pozita e "Inspektor i Lartë për Hetime Tatimore" të cilën e mban ankuesi në Administratën Tatimore të Kosovës dhe pozita e "Ekspert i Pavarur Financiar " pranë "Këshillit Gjyqësor të Kosovës" paraqesin konflikt interesi sepse sipas formularit të përshkrimit të detyrave të punës i njëjti (heton analizon dhe kontrollon rastet e caktuar për dyshim të shmangies tatimore, ka përgjegjësi të mbledhë, përpunoj, ruaj, analizoj dhe të hetojë nëse është kryer vepra penale për shmangie tatimore , ka kontakt të drejtpërdrejtë me prokuror publik, policinë krimineve të renda ekonomike, banka komerciale, dhe institucione tjera, merr pjese ne bastisje, interviston dhe merr ne pyetje te dyshuarit për shmangie tatimore si dhe dëshmitaret e përfshinë ne rast, përgatit raporte ne baza te rregullta raportuese etj.), po ashtu pozita e Ekspertit të Pavarur Financiar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës nuk lejohet sipas nenit 6 të Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës, ku sipas deklarimeve të zyrtareve të ATK-së dhe arsyetimit në Vendimin e atakuar kjo rregullore është hartuar me përfshirjen e zyrtareve kompetentë nga Agjencia për Parandalim të Korrupsionit dhe është në harmoni me Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në

Ushtrimin e Funksioneve Publik, andaj Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të të gjitha provave dhe fakteve të bashkangjitura ne shkresat e lëndës ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka shqyrtuar edhe përgjigjen zyrtare me numër 1394/23 të datës 12.07.2023 të ofruar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit respektivisht Drejtori i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ne kërkesën e ankuesit lidhur me ekzistimin e mundshëm tw konfliktit tw interesit në angazhimin ne pune sekondare si ekspert i pavarur për përpilimin e ekspertizave financiare krahas funksionit publik "Inspektor i Lartë për Hetime Tatimore" dhe ka konstatuar se Agjencia për parandalimin e Korrupsionit ka ofruar përgjigjen me tekstin si në vijim:..... Sa i përket interpretimit dhe zbatimit te dispozitave te LPKI-sw...agjencia ne cilësinë e autoritetit qendror për zbatimin e ligjit ne fjale ju njofton se te qenurit "Inspektor i Lartë për Hetime Tatimore" në ATK dhe Ekspert Financiar në "Këshillin Gjyqësor tw Kosovës, apriori nuk bie ndesh me dispozitat e LPKI,. Megjithatë me rastin e angazhimit si ekspert përpilimin e ekspertizave financiare krahas te qenurit Inspektor i Lartë për Hetime Tatimore ne ATK , duhet pasur parasysh zbatimin e ndalesave te përcaktuara me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nenparagrafet 1.1, 1.2, dhe 1.3 tw LPKI-sw se : 1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse: "1.1. mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private; 1.2. punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë; 1.3. angazhime të tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit.. Kësisoj punëdhënësi me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për angazhim në punë sekondare, varësisht nga përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësiwe te zyrtarit, duhet ta vlerësoj nëse angazhimi i zyrtarit si ekspert i pavarur për përpilimin e ekspertizave financiare bie ndesh me dispozitat e sipërcituara te nenit 11 të LPKI-së. Në rastin konkret, nga vendimi që ia keni bashkangjitur kërkesës suaj shihet se punëdhënësi juaj me rastin e vendosjes për kërkesën tuaj, është mbështetur edhe ne nenin 11 tw LPKI-së".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit si dhe pasi ka analizuar përgjigjen zyrtare nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse në rastin konkret organi i punësimit gjegjësisht Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr. 12-06-3206 të datës 22.08.2023 me të cilin e ka refuzuar kërkesën për lejimin e punës sekondare të ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozitat e lartcekura respektivisht organi i punësimit ka vlerësuar se angazhimi ne pune sekondare si Ekspert i Pavarur Financiar për përpilimin e ekspertizave financiare krahas funksionit publik "Inspektor i Lartë për Hetime Tatimore" bie ndesh me dispozitat e nenit 11 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike dhe Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se Vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1169/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

Ankuesit

Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
Arkivit të KPMSHCK- së.